



**Për: Mediat e shkruara dhe elektronike**  
**Nga: Departamenti për Marrëdhënie me Publikun dhe Informim**  
**Subjekti: Urim**

---

*Prishtinë, 08 Mars 2008*

## **URIM**

Aleanca Kosova e Re, me respekt të veçantë, ua uron 8 Marsin të gjitha Nënave shqiptare, duke çmuar lartë kontributin e tyre për Kosovën Shtet të Pavarur dhe Sovran.

Dita e Nënës, festa e 8 Marsit, është momenti më i mirë për të vlerësuar lartë rolin e femrës në emancipimin shoqëror dhe në potencialin që kanë ato për të ndërtuar një shoqëri të shëndoshë, të edukuar dhe të dinjitetshme.

Ky është 8 Marsi i parë në Shtetin e Pavarur të Kosovës, prandaj kjo festë, këtë herë, merr një kuptim të veçantë. Përveç të tjerash, kjo datë, duhet të përcillet me falënderim dhe respekt të vazhdueshëm ndaj femrës dhe rolit të saj veçanërisht në shoqërinë kosovare. Breza e breza me radhë janë edukuar në frymën kombëtare të tolerancës dhe emancipimit, dhe padyshim një pjesë e madhe e këtyre meritave, i takojnë Nënave shqiptare dhe përkushtimit civilizues që treguan ato.

AKR do të jetë gjithmonë aktive, që të mbështes rolin e gruas në shoqërinë kosovare, për ti dhënë asaj hapësirë të emancipimit dhe të integritit në të gjitha sferat sociale në Kosovë.

Zyra për informim  
Aleanca Kosova e Re